

V E N D I M
Nr.457, datë 28.6.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.403, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.403, datë 11.6.2001 të Këshllit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.”.

2. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta